

Kampet e përqendrimit

Gerhard Baumgartner

Puna e dhunshme | Kampi Lackenbach “Cigan” | Geto Lodz dhe kampi asgjësues Chelmno | Kampet e përqendrimit në Auschwitz-Birkenau | Persekutimet në territoret e okupuara gjermane


➤ Pas një periudhe relativisht të shkurtër të masave gjithnjë e më të shtrënguara ndaj tyre, prej vitit 1938 e më tej romët në Rajhun gjerman, në territoret e okupuara gjermane dhe vendet shoqëruese përjetuan dëbime, paraburgime dhe vrasje. Deri në vitin 1945 përafërsisht një nga katër romë që jetonin në Evropën e paraluftës kishte rënë viktimë e persekutimit Nacional Socialist.

NUMRI I VIKTIMAVE

Numri i viktimave rome gjatë Holokaustit mbetet një fushë e debatit kundërthënës në mes të historianëve dhe aktivistëve për minoritete. Vlerësimet e mëhershme të 500,000 Romëve, që gjoja ranë viktimë të persekutimit Nazist, sigurisht se janë ekzagjeruar dhe deri më tani nuk janë konfirmuar nga kërkimet shkencore. Deri më tani, dokumentacioni konkret historik është nxjerrë për rreth 50,000 viktima brenda Rajhut Gjerman dhe territoreve të okupuara gjermane, dhe përafërsisht edhe 50,000 viktima në vendet e qeverisura nga qeveritë satelitore fashiste të Rajhut. Pasi që shumë nga burimet në dispozicion dhe materialet arkivore janë të paplota dhe të dyshimta, numri i përgjithshëm i viktimave të mundshme rome mund të vihet në një minimum prej 250,000.

KAMPET E PËRQENDRIMIT, KAMPET E ASGJËSIMIT, GETOT, (1936-1945)

III. 1 (bazuar në Vossen 1983, p. 87; Tcherenkov / Laederich 2004, f. 161)



PARATHËNIE

Persekutimi i egër i romëve nga nazistët gjerman – dhe fashistët tjerë – i kishte rrënjët në tri karakteristika të ndryshme të mendimit dhe politikave evropiane në gjysmën e parë të shekullit të 20-të. Anti-“Ciganizmi” tradicional, një përzjerje e ndërlikuar e paragjykimëve shoqërorë– siç ishte ideja se “Ciganët” ishin bartësit e sëmundjeve të rrezikshme dhe prireshin të vidhnin fëmijë kurdo që ishte e mundur – e pranua gjerësisht përgjatë tërë

Evropës. Në fillim të shekullit të 20-të kjo u kombinua me formën e egër të racizmit, që besonte se e ashtuquajtura “sjellja anti-sociale” të ishte një tipar trashëgues i disa grupeve të popujve. Karakteristika e tretë vendimtare i mekanizmave persekutues – e përhapur nga nazistët gjerman pas ngritjes së tyre në pushtet në vitin 1933 – ishte sistemi i të ashtuquajturës “luftim parandalues i krimeve”, që iu mundësonte autoritetëve të arrestonin dhe burgosnin çdonjërin, të cilin ata konsideronin të ishte me gjasë “i rrezikshëm” për shoqërinë,

edhe nëse ata nuk kishin kryer ndonjë krim ose ndonjë prapësi.

Klima e ashpër ekonomike gjatë viteve ndërmjet dy luftërave në Evropë edhe më tepër kontribuuan në fërkimin e shtuar në mes të romëve dhe jo-romëve në vendet evropiane. Posaçërisht në Evropën qendrore dhe lindore shumë romë jetuan ose si zejtarë shëtitës ose si punëtorë bujqësor. Gjatë të ashtuquajturit “Depresion” në fund të viteve 1920-ta dhe në fillim të 1930-ve shumë romë humbën këto forma tradicionale të të ardhurave dhe ishin të prirë për

Puna e dhunshme

Kampi Lackenbach "Cigan"

Geto Lodz dhe kampi asgjësues Chelmo

Kampet e përqendrimit në Auschwitz-Birkenau

Persekutimet në territoret e okupuara gjermane



III. 2

Brendia e një barake të "Kampit Cigan" në Auschwitz-Birkenau. Mbishkrimi në tavan lexon: "Sei ehrlich" ("Bëhu i sinqertë").

(nga Nečas 1999, f. 96b)

Paula Nardai, një rome nga Oberwart, Austria, rikujton fatin e familjes së saj në Auschwitz-Birkenau

"Babai im ishte atje, nëna ime, motra ime tetëmbëdhjetë vjeçare, unë dhe vëllai im nëntë vjeçar. Dhe vëllai im, gjithashtu, që ishte më i vjetër; që kishte punuar në Kiel. Nëna ime –një muaj, mund të them, një muaj ajo mbijetoi. Babai im, ata e goditën në kokë aq tmerrshëm sa që ai u verbua. Ishte një barakë që e quanin 'Lazarett' (gjiri i sëmurë) – nëse të vendosnin aty, kurrë nuk ktheheshe prapë. Ata e rrahën derisa u verbua. Ata e vranë, më nuk e pamë prapë. Motra ime shkoi në kuzhinë, ata e morën për të qëruar patate. Dhe vëllai im i vogël, ishte hera e parë që ai duhej të punonte. Unë nuk isha aty, e lashë atë në shtëpi në barakë, unë shkova në mëngjes, në 'Außenkommando' (skuadrilje e jashtme) isha në punë, dhe kur erdha në shtëpi, çka të shoh? Fëmija nuk është aty. Unë pyes të tjerët: 'Ku është fëmija?' – 'Ata e morën jashtë.' Ata morën fëmijët dhe i dërguan në dhomat e gazit. Dhe mua nuk mu lejua më të dal jashtë. Nuk mund të shkoja jashtë të pyesja dikë, sepse nuk lejoheshja të largoheshja nga baraka në kohën e përfundimit. Vetëm 'zum Abzählen' (të numëroja) – prapë."

III. 3 (nga Romani Patrin 2/1998, f. 10)

mirëqenie publike dhe kujdes shëndetësor. Mirëpo, shumica e fshatrave dhe qyteteve hezitonin të merrnin këtë barrë financiare – duke pohuar se "Ciganët" nuk iu përkisnin popujve të tyre– dhe tentuan t'i largonin në komunat tjera. Forcat policore gjermane dhe austriake filluan të regjistronin romët në të ashtuquajturat "Zigeunerlisten" (listat "Cigane") dhe t'i fotografonin e tu merrnin gjurmët e gishtërinjve goxha më herët sesa ngritja në pushtet e nazistëve, lista të cilat më vonë dolën të ishin fatale për shumicën e personave të regjistruar. Këta faktorë formuan prapavijën për persekutimin e shtuar të të ashtuquaj-

turve "Ciganë" pas ngritjes në pushtet të nazistëve në vitin 1933. Veç në vitin 1933 romët u detyruan t'i nënshtroheshin sterilizimit dhe në vitin 1935 një ligj special ua ndaloj martesat në mes të "Ciganëve" dhe "Arianëve". Në mes të viteve 1936 dhe 1938 u krijuan dy institucione qendrore për persekutimin e "Ciganëve", të ashtuquajturat "Rassehygienische Forschungsstelle" (Qendra Kërkimore për Higjienë Racore) dhe "Reichszentrale für die Bekämpfung des Zigeunerunwesens im Reichskriminalpolizeiamt" (Qendra e Rajhut për Luftimin e Murtajes Cigane brenda Zyres së Rajhut të Policisë Kriminale).

Autoritetet lokale jo vetëm që përkrahnin këto politika kundër romëve por shpesh nxitnin institucionet qendrore të përshpejtonin dhe intensifikonin masat, siç ishte rasti i pamfletit famëkeq nga "Gauleiter" nazist i Burgenlandit, Tobias Portschy. Në vitin 1938 Heinrich Himmler – komandanti i SS ("Schutzstaffel", Skuadrilja Mbrojtëse) dhe Shefi i Rajhut të policisë gjermane – dekretoj të "zgjidhej çështja Cigane" sipas "parimeve racore" dhe në vitin 1939 nënshtroi një dekret special duke detyruar të gjithë romët të hiqnin dorë nga udhëtimi dhe të qëndronin në qytet ku ishin duke qëndruar në atë kohë.

PUNA E DHUNSHME

Duke filluar nga viti 1938 dhe 1939, "Zyra e Rajhut e Policisë Kriminale" urdhëroi që rreth 3,000 meshkuj dhe femra, të cilët ishin në gjendje të kryenin punë të vështira fizike, të dëboheshin në kampe të përqendrimit. Himmlerit i nevojiteshin këta të burgosur për zhvillimin e një industrie të kontrolluar nga SS. Berlini u bind, që romët dosido nuk kishin punë të leverdishme. Por kjo ishte gabim. Pas aneksimit të

Austrisë nga Rajhu gjerman romëve iu ndalua vazhdimi i disave nga profesioneve tyre tradicionale, p.sh. performimi i muzikës në publik. Për shkak të lulëzimit të industrisë së armëve të nxitur nga lufta, shumë romë gjetën punë në fabrika, në vend ndërtime dhe në sektorin e bujqësisë. Madje edhe Stiriani "Gauleiter" Uiberreither kritikoi pasojat e këtyre dëbimeve, por i përkrahu për shkak të motiveve racore: "Edhe pse këta janë Ciganë të punësuar drejtësisht, të cilët dëshirojnë të punojnë dhe nuk kanë vepra të mëhersh-

me kriminale dhe në asnjë mënyrë nuk përbëjnë barrë për shoqërinë, unë do të urdhëroj internimin e tyre në kampet e punës së dhunshme për shkak të vlerësimit se një Cigan – si dikush që qëndron jashtë Volksgemeinschaft (komunitetit të njerëzve) – është gjithmonë asocial."

Në vitin 1940 Himmleri urdhëroi që një grup tjetër prej përafërsisht 2,500 romëve (kryesisht Sinti) nga territori i Rajhut gjerman të dëboheshin në Protektoratin e Përgjithshëm në Poloninë e sotshme.

III. 4

“Einweisungs-Übersicht” (“Pasqyra e internimit”) të getos Lodz me 13 nëntor, 1941, ku renditeshin pesë transporte me “gjithsej 4,996 Ciganë të gjallë, 11 të vdekur”, duke shtuar se “11 Ciganët e vdekur vdiqën gjatë transportit me tren”.

Barbara Richter, një e mbijetuar Çeke nga kampi i Auschwitz:

“Jam mbajtur gjashtë javë në stacion policor dhe pastaj jam dërguar në Auschwitz (kam arritur atje me 11 mars, 1943). Dy Ciganë tentuan të iknin por u zunë, u rrahën dhe u varën. Më vonë familja ime u lirua nga Lettig për shkak se Richterët ishin një familje e ngritur në Bohemi. Nëna ime erdhi në Auschwitz vullnetarisht. Njëherë më fshikulluan me kamxhik njëzet e pesë herë sepse i kisha dhënë pak bukë një të ardhurë të re. Një ditë pashë Elisabeth Koch duke vrarë katër fëmijë Ciganë sepse ata kishin ngrënë mbeturinat e një ushqimi. Një herë tjetër ne qëndruam për dy orë para krematoriumit por në momentin e fundit u kthyem prapa në baraka. Për herë të dytë u fshikullova për marrjen e ushqimit nga një i burgosur i vdekur. Ata më morën gjakun tri herë. Dr. Mengele më injektoi me malaria. Pastaj isha në gjirin e sëmurë me axhën tim. Disa Ciganë më dërguan në një bllok tjetër vetëm pak kohë para se të gjithë pacientët në gjirin e sëmurë, përfshirë axhën tim, u vranë.”

III. 5 (nga Crowe 1995, p. 51)

ANLEGE II
S.A.H.-Bord. Litzmannstadt, den 13. 11. 1941.
- 10 (1) -

Einweisungs-Übersicht
(Gegensatz)

Nr.	A n f u n g				A u s l a ß e n	
	Platz	Zeit	Ort	Zeit	Zug	Personen
1	5.11.41	11.00	5.11.41	10.00	5.11.41	35 Hn.
2	6.11.41	11.00	6.11.41	17.30	7.11.41	30 Hn.
3	7.11.41	11.00	8.11.41	13.30	8.11.41	50 Hn.
4	8.11.41	11.00	8.11.41	01.30	8.11.41	10 Hn.
5	8.11.41	11.00	8.11.41	13.30	8.11.41	10 Hn.

Auszahl der eingewiesenen Zigeuner:

1. Transport von Hamburg 990 Lebende, 2 tote Zigeuner
2. " " Pilsenerfeld 1 000 Zigeuner
3. " " Hohenleuben 1 000 " "
4. 2 " Hohenleuben 990 Lebende, 6 tote Zigeuner
5. " " Oberwart 1 000 " , 1 toter " "

Insgesamt 4 996 Lebende, 11 tote Zigeuner.

Die 11 toten Zigeuner starben während des Bekleidertransportes.
Gesamt der Zigeuner durchgeschickte 50 Hn.

KAMPI LACKENBACH "CIGAN"

Me 23 nëntor, 1940, “Kampi Cigan” u vendos në ndërtesat e një ish ferme çifligare. Kampi u administrua nga shtabi i policisë kriminale në Vjenë, shpenzimet u ndanë në mes të administratave të distrikteve Bruck an der Leitha, Eisenstadt, Lilienfeld, Oberpullendorf, St. Pölten dhe Wiener Neustadt dhe administratës komunale të qytetit të Vjenës në proporcion me numrin e të burgosurve që vinin nga distriktet përkatëse. Romët e internuar duhej të jetonin në kushte më primitive në hangarët dhe ahuret e ish-fermës çifligare dhe shfrytëzoheshin si punëtorë me dhunë në ndërmarrjet e ndryshme lokale. Nën kushtet “normale”, numri i njerëzve të internuar në Lackenbach ndryshonte prej 200 deri në 900 persona, ku një e treta e tyre ishin fëmijë. Numri më i madh i 2,335 të të burgosurve u arrit me 1 nëntor, 1941. Prej 4,000 romëve të internuar në Lackenbach rreth 2,000 u dëbuan në geto në Lodz dhe në kampin asgjësues në Chelmno në vjeshtë të vitit 1941. Vetëm disa qindra romë mbijetuan që të shohin çlirimin e kam-

pit Lackenbach nga trupat sovjetike në prill 1945. Përkundër standardeve tepër të këqija të jetesës, higijenës dhe ushqimit, romët e burgosur në kampin Lackenbach u detyruan në punë të dhunshme. Ata iu dhanë me qira ndërmarrjeve të ndryshme, si në toka pyjore, prona bujqësore, ferma, vende për punimin e tullave, dhe ferma të krimbit të mëndafshit, ose u urdhëruan të punonin në projektet e ndërtimit të rrugës publike. Rrogat e tyre i dorëzoheshin administratës së kampit, ndërsa vetë romët merrnin “paratë e xhepit”. Prishja më e vogël e disiplinës në kamp dënohej ashpërsisht me rrahje, lexim të pambanueshëm të emrave dhe ndalim të ushqimit. Në vitin 1942 kushtet e tmerrshme të jetesës rezultuan në shpërthimin e epidemisë së etheve të tifos që vrau shumë nga të burgosurit e kampit. Në mes të viteve 1940 dhe 1945 gjithsej 237 njerëz humbën jetën e tyre në kampin Lackenbach.

GETO LODZ DHE KAMPI ASGJËSUES CHELMNO

Me 1 tetor, 1941, Heinrich Himmler urdhëroi dëbimin e 5,007 romëve, shumica Arian, në geton e Lodz (“Lit-

zmanstadt”). Shpenzimet e këtyre dëbimeve u ndanë në mes të “Reichsicherheitshauptamt” (Zyra Kryesore e Rajhut për Siguri) në Berlin dhe administratave regjionale për mirëqenie shoqërore. Personat që do të dëboheshin u përzgjodhën sipas asaj nëse nuk ishin në gjendje të punonin, ata “të cilët nuk ishin barrë për mirëqenien sociale” u lejuan të qëndronin. Familje të tëra u dëbuan së bashku, në mesin e tyre 2,689 fëmijë, që përbënin më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të të dëbuarve. 613 të dëbuar vdiqën gjatë javëve të para në Lodz nga ethe e tifos. Në dhjetor 1941 dhe janar 1942 të gjithë romët që ishin ende të gjallë deri atëherë u dërguan në kampet asgjësuese afër Chelmno dhe u helmuan me gaz. Në mars të vitit 1942 zyra e policisë kriminale Graz urdhëroi që të gjitha kërkesat e familjarëve të brengosur t’i dërgoheshin “Reichsicherheitshauptamt” (Zyrës Kryesore të Rajhut për Siguri), dhe që të kundërshtoheshin kërkesat tjera me argumentin se në rastin e të gjithë personave të “rivendosur” në Lodz nuk mundësoheshin të drejta për vizitë. Në këtë kohë të gjithë romët austriak të dëbuar në Lodz veç kishin vdekur. [III. 4]

KAMPET E PËRQENDRIMIT NË AUSCHWITZ-BIRKENAU

Pas diskutimeve intensive lidhur me të ashtuquajturën “Politikë Cigane” Himmleri urdhëroi dëbimin e të gjithë “zi-geunerische Personen” (“personave të ngjashëm me Ciganët”) në kampet e përqendrimit. Libri i kampit i të ashtuquajturit “Kampi Cigan” në Auschwitz-Birkenau regjistroi 10,649 femra dhe 10,094 meshkuj të burgosur, shumë prej tyre fëmijë. Dy të tretat e romëve të burgosur ishin arrestuar në Gjermani dhe Austri, më shumë se 20 përqind erdhën nga Bohe-mia dhe afër 6 përqind nga Polonia. Çdo ditë të burgosurit e sëmurë dhe të dobët vdisnin dhe në mënyrë të përsëritshme një numër i madh i të burgosurve të sëmurë u dërguan në dhomat e gazit, në mesin e tyre një numër i madh romëve gjerman dhe austriak me 12 maj, 1943. Deri në fund të vitit 1943, 70 përqind të të burgosurve në “Kampin Cigan” veç kishin vdekur. Kah fundi i korrikut të vitit 1944 të gjithë të burgosurit e “Kampit Cigan” në Auschwitz-Birkenau, të cilët ende mendoheshin të jenë në gjendje të punonin, u transferuan në kampet tjera të përqendrimit dhe u detyruan në kryenin punë të dhunshme në fabrika dhe uzina industriale. Me 2 gusht, 1944, trupat e SS-së e rrethuan “Kampin Cigan” dhe natën e ardhshme të gjithë të burgosurit

e mbetur në “Kampin Cigan” u vranë në dhomat e gazit. [Ills. 3, 5]

PERSEKUTIMET NË TERRITORET E OKUJARA GJERMANE

Gjatë okupimit gjerman të regjioneve perëndimore të BRSS-së në vitin 1941 me mijëra romë u vranë në likuidimet masive së bashku me çifutët dhe funksionarët komunistë. Në të njëjtin vit, trupat e “Wehrmacht” (ushtirisë) gjermane vranë me mijëra romë në Serbi dhe në të njëjtën kohë forcat policore gjermane vranë një numër të madh të romëve në Poloni.

Në mes të vitit 1944 dhe fillimit të vitit 1945 me mijëra romë sllovak dhe hungarez u vranë ose dëbuan në kampet e përqendrimit. Posaçërisht romët nga Hungaria jugore dhe perëndimore u arrestuan nga fashistët hungarez dhe në marshet e vdekjes u dërguan në kampin qendror në Csilla afër qytetit të Komárom në Hungarinë veriore, prej nga të mbijetuarit u dëbuan nga SS gjermane. Shumë romë të mbijetuar hungarez u vranë nga trupat gjermane dhe fashistët hungarez në fillim të vitit 1945, kur arritën për kohë të shkurtë t’i ripush-tonin territoret, të cilat veç ishin pushtuar nga trupat e avancuara sovjetike. Në Sllovaki qeveria vendosi të ashtuquajturin “Kamp Cigan” në Dubnica dhe

Vahom ku rreth 800 njerëz u internuan nën kushte të tmerrshme dhe më vonë u vranë ose dëbuan.

Në Rumani dhe Kroaci persekuzioni i romëve nën qeveritë përkrahëse fashiste të Rajhut gjerman ishte po aq i ashpër dhe mizor. Llogaritjet e viktimave në kampin e përqendrimit kroat në Jasenovac ndryshojnë në masë të madhe, por numri i përgjithshëm i romëve kroat, të cilët ranë viktimë e Holokaustit, duhet të jetë së paku 25,000. Po aq problematike janë llogaritjet e ndryshme të viktimave romë në mesin e 25,000 romëve rumun që u dëbuan në Transnistria, shumica e të cilëve me gjasë nuk mbijetuan. Numrat për dëbimet në Transnistria nga Bullgaria janë edhe më të paqarta. Në njërin anë kërkimi i këtyre ngjarjeve tragjike është neglizhuar për dekada, ndërsa në anën tjetër numri i viktimave të këtyre regjimeve fashiste është ekzagjeruar në mënyrë të papërgjegjshme nga propaganda komuniste pas vitit 1945.

Fati i romëve në Italinë e okupuar nga Gjermania deri më tani është hulumtuar vetëm në mënyrë të kufizuar, si dhe fati i romëve dhe Sinti nga vendet Baltike të Estonisë, Latvisë dhe Lituaniës. Për Danimarkën e okupuar nga Gjermania, Norvegjinë, Greqinë dhe Bullgarinë deri më tani historianët nuk kanë gjetur ndonjë dokumentacion të dëbimit sistematik dhe likuidimeve të romëve.

Bibliografia

Crowe, David M. (1995) A History of the Gypsies of Eastern Europe and Russia. London / New York: Tauris | Dlugoborski, Waclaw (ed.) (1998) Sinti und Roma im KL Auschwitz-Birkenau 1943-1944. Vor dem Hintergrund ihrer Verfolgung unter der Naziherrschaft. Oswiecim | Freund, F. / Baumgartner, G. / Greifeneder, H. (2004) Vermögensentzug, Restitution und Entschädigung der Roma und Sinti. Wien: Oldenbourg | Ioanid, Radu (2000) The Holocaust in Romania. The Destruction of Jews and Gypsies under the Antonescu Regime 1940-1944. Chicago: Dee | Kenrick, Donald (ed.) (1999) In the Shadow of the Swastika. The Gypsies during the Second World War 2. Hatfield: University of Hertfordshire Press | Nečas, Ctibor (1999) The Holocaust of Czech Roma. Prague: Prostor | Tcherenkov, Lev / Laederich, Stéphane (2004) The Rroma. Volume 1. History, Language and Groups. Basel: Schwabe | Vossen, Rüdiger (1983) Zigeuner. Roma, Sinti, Gitanos, Gypsies zwischen Verfolgung und Romantisierung. Frankfurt am Main: Ullstein. | Zimmermann, Michael (1996) Rassenutopie und Genozid. Die nationalsozialistische „Lösung der Zigeunerfrage“. Hamburg: Christians